

EPPC Albania kërkon një **SAP Consultant** për klientin e saj, një nga rrjetet më të njohura të supermarketeve.

Përgjegjësitë kryesore:

- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e Sistemit Informativ të Kompanisë për të siguruar disponueshmërinë e saktë dhe në kohë të të dhënave për proceset e vendimmarrjes;
- Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave të menaxhimit të të dhënave për të garantuar sigurinë e tyre;
- Bashkëpunimi me departamente të ndryshme për të kuptuar nevojat e tyre për menaxhimin e të dhënave dhe për të ofruar udhëzime dhe mbështetje në krijimin e proceseve efikase të mbledhjes, ruajtjes dhe marrjes së të dhënave;
- Monitorimi dhe analizimi i performancës së sistemeve për të identifikuar fushat për përmirësim, ndjekja e zhvillimit të tyre dhe zgjidhja e problemeve për të minimizuar kohën e ndërprerjes;
- Kryerja e auditimeve të rregullta të të dhënave për të identifikuar dhe zgjidhur çështjet e cilësisë së të dhënave, duke siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të përdorura për raportim dhe analizë;
- Trajnimi dhe mbështetja e përdoruesve fundore në përdorimin efektiv të SAP-it, duke ofruar udhëzime për shtimin, heqjen dhe interpretimin e të dhënave;
- Përgatitja dhe prezantimi i raporteve dhe analizave të nxjerra nga të dhënat e sistemit për të mbështetur proceset e vendimmarrjes strategjike;
- Menaxhimi i buxhetit për sistemin, duke siguruar shpenzimin e duhur për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e tij;
- Organizimi i trajnimeve periodike për stafin për të rritur aftësitë në përdorimin e sistemit.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Përvojë në përdorimin e teknologjive dhe menaxhimin e infrastrukturës së bazuar në cloud;
- Njohje të sistemeve si SAP, Windows, Linux, Unix dhe gjuhëve të programimit si Java dhe Python;
- Çertifikime profesionale në menaxhimin e sistemeve të informacionit (p.sh., PMP, ITIL, CISSP);
- Aftësi për të menaxhuar dhe analizuar të dhëna të mëdha dhe përdorimi i mjeteve të analizës së avancuara;
- Njohuri të thelluara në integrimin e sistemit dhe përdorimin e API-ve për ndërveprim midis aplikacioneve të ndryshme;
- Njohuri të përparuara në përdorimin e AI dhe Machine learning (ML) për përmirësimin e proceseve të biznesit;
- Eksperienca në menaxhimin e Bazës së të Dhënave: SQL, MySQL.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.